

SHTOJCE

Lidhur me procedurën e prokurimit “Të hapur” me REF-56712-04-23-2020, me objekt **“Blerje mjete dhe pajisje (Tools)”** dhe fond limit prej 64,436,637 (gjashtëdhjetë e katër milion e katërqind e tridhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) lekë (pa TVSH), i parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.05.2020, Autoriteti Kontraktor AGS SHA mbështetur në nenin 42, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, për arsye të një ankese si dhe me iniciativën e vet ka modifikuar dokumentet e tenderit, si dhe sqaron për sa më poshtë vijon:

1. Lidhur me kriterin në pikën 2.4, gërma “e” të Shtojcës 9 të DT, ku është kërkuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: *“Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ISO 18001:2007, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente)”*, sqarojmë se **AK do të pranojë ne tender jo vetëm Certifikatën ISO 18001:2007 me afat të vlefshëm, por edhe certifikatën ISO 45001 që ka zëvendësuar këtë ISO, ndaj AK në këtë kriter ka përfshirë togfjalëshin “ose ekuivalent”**.
2. Kriteri në pikën në pikën 2.4, gërma “h” të Shtojcës 9 të DT, ku kërkohet që: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht në stafin e tij, 1 (një) inxhinier mekanik dhe 1 (një) inxhinier elektrik për tre mujorin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, vërtetuar kjo me listëpagesa sipas legjislacionit tatimor”*, ndryshohet si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht në stafin e tij, 1 (një) inxhinier mekanik dhe 1 (një) inxhinier elektrik. Për të plotësuar këtë kriter operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi kualifikimi për te dy inxhinierët, si dhe listëpagesat për tre mujorin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, sipas legjislacionit tatimor.

3. Lidhur me kriterin në pikën 2.4, gërma “i” të Shtojcës 9 të DT, ku është kërkuar se *“Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SHA që kanë lidhje me realizmin e objektit të kësaj kontrate. (Ky kod është i publikuar në SPE së bashku me DT) ju sqarojmë se, së bashku me këtë shtojcë do të gjeni të publikuar në SPE si edhe në faqen zyrtare të Albanian Gas Services Company SH.A, Kodin e Etikës së Shoqërisë AGS sh.a.*

(Ju bëjmë me dije se, AGS SH.A është një shoqëri aksionare italo-shqiptare, e cila në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektesise,

transparences, efikasitetit dhe tregut te lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar ndër të tjera edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoret e paligjshme, marreveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjeret etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t'i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, **prandaj përpara se operatorët ekonomikë të deklarojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t'i zbatojnë këto rregulla).**

4. Përsa i përket, përcaktimit në shtojcën 10 të DT se: *“Fituesi i tenderit do të dorëzojë mallin të shoqëruar me manuale/udhëzues në gjuhën shqipe dhe italiane”* ndryshohet si më poshtë:

Fituesi i tenderit do të dorëzojë mallin të shoqëruar me manuale/udhëzues të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Gjithashtu, ky përcaktim do të jetë i vlefshëm edhe për të gjitha skedat teknike ku janë kërkuar manualët ose udhëzuesit në gjuhën shqipe ose italiane.

Sjellim në vëmendjen e operatorëve ekonomikë se, nuk është e nevojshme të përkthehen komplet manualët/udhëzuesit e mallrave, por vetëm pjesët ku janë përcaktuar të dhënat teknike të kërkuara në skedat teknike.

5. Duke qenë se, në formularin e ofertes, shtojca 1 si dhe te preventivi shtojca 12, nuk janë përcaktuar njësitë (cope apo sete), AK publikon preventivin e modifikuar duke shtuar përcaktimet copë ose sete.

Afati për hapjen e ofertave ka qenë:

Data 18.05.2020 , Ora: 11⁰⁰

Bëhet

Data 25.05.2020, ora 11⁰⁰